– Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË

• Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.ű

Njoftojmë punonjësit dhe konsumatorët tanë se zgjatëm orarin e hapjes së zyrës së FLP-s së Zagrebit: të hënën dhe të enjten: 09:00 - 20:00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09:00 - 17:00. Tel: 01/ 3909 770; Fax: 01/ 3704 814. Porositë telefonike: 01/ 3909 773.

• Zyra e Splitit: 21000 Split. Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00; të martën, të mërkurën, të enjten dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

Porosia telefonike: 01/3909 773. Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti, çmimi i transportit paguhet nga FLP-ja. Leksionet rreth produkteve dhe marketingut organizohen të hënën, të martën, të mërkurën dhe të enjten nga ora 17 në zyrën qendrore. Orari i hapjes së qendrës: të hënën dhe të

enjten 12:00 – 20:00, të martën dhe të mërkurën 11:00 – 19:00, dhe të premten 09:00 – 17:00. Takimet mund të lihen në numrin telefonik 01/ 3909 773.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM: nga 1 marsi nëse blini produkte me vlerë më të madhe se 1500 kuna, apo përdorni shërbimet e sallorit kozmetik, me kartën tuaj DC mund të paguani edhe me këste (2-3 këste). Shfrytëzoheni mundësinë e blerjes me ulje. Për detajet interesohuni tek sponsori juaj ose tek punonjësit e zyrës.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510
(në ditët eke ndërmjet orës 16.00 dhe 20.00)
Dr. Eugenija Sojat Marencic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLLOVENISË

• 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

• Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel.: +386-2-575-12-70, Fax: +386-2-575-12-71, e-mail: forever.living@siol.net.

Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788, Dr. Canzek Olga: +386-41824163



Zyra e Lendvait



NJOFTIMET E ZYRËS SË SHQIPËRISË

• Shqipëri, Tiranë, Reshit Collaku 96, Villa Forever 36.

Fax: +355 4230 535

Drejtori rajonal: Attila Borbath

Drejtori i zyrës: Xhelo Kijaçaj, tel: +355-4-230-535.

Kontaktim: në ditët e punës në orarin 09.00-13.00, 16.00-20.00

www.flpseeu.com **FLP TV** në internet

Programi i FLP TV nga 26 qershor deri më 19 korrik 2008

18.00 dhe 06.00 Berkics Miklos: Në krye të Europës
18.20 dhe 06.20 Breakdance
18.45 dhe 06.45 Ëndrra jote është plani ynë: Hyrje në FLP
18.47 dhe 06.47 Ëndrra jote është plani ynë: Produktet FLP
18.50 dhe 06.50 Ëndrra jote është plani ynë: Mundësia FLP
18.55 dhe 06.55 Adolf L. Kosa
19.20 dhe 07.20 Borago: Kroncert prezatues i albumit të ri
19.35 dhe 07.35 Plani marketing i FLP-s
19.55 dhe 07.55 SAPPHIRE: Kualifikimi i Dr. Sandor Milesz
20.20 dhe 08.20 Zsolt Arpad Meszaros: Kënga me titull Bangkok i musicalit Miss Saigon
20.25 dhe 08.25 Aranka Vagasi: Ndajja e profitit 2008
20.45 dhe 08.45 Vlerësimi i shteteve

21.45 dhe 09.45 Supervisorë, Assistant m...
22.20 dhe 10.20 Pjesë nga musicali me titull zëri i Muzikës
22.40 dhe 10.40 Managerë, managerë drejtues
00.05 dhe 12.05 Supervisorë, Assistant m...
00.30 dhe 12.30 Sugarloaf
00.55 dhe 12.55 Managerë, managerë drejtues
02.20 dhe 14.20 Përmbledhje
02.40 dhe 14.40 Kormoran
03.00 dhe 15.00 Bence Nogradi: Leksion surprizë
03.30 dhe 15.30 Managerë të rinj
04.35 dhe 16.35 Robert Rudics: Teknika të ndërtimit të rrjetit
04.55 dhe 16.55 Managerë të rinj 2

GËZUAR PËRVJETORIN E FOREVER-IT



13 maj 1978 ishte fillimi zyrtar i Forever Living Products. E dinim se kjo ishte një ide e shkëlqyer, patëm besim tek forca e aloe vera-s dhe në gjithë këtë më e bukura ishte se arritëm ta fusim në jetën e njerëzve. Pra kishim një produkt të ri dhe një plan marketing të shkëlqyer me të cilin e filluam. U treguam të gjithëve rreth biznesit, kishte nga ata që na dëgjuan dhe kishte nga ata që jo, por s'kishte problem, ne folëm mëtej. Prandaj edhe sot e kësaj dite ne njihemi si "Zëri i Aloe-s".

Edalluam menjëherë mundësinë e prezantimit të biznesit tonë tek njerëzit dhe kur qarkullimi filloi të rritej me shpejtësi rakete, Forever-i filloi të marrë formë. Natyrisht kjo s'ishte aq e lehtë sa mendoni, nevojitej puna e madhe e shumë njerëzve të mrekullueshëm që Forever të bëhej ai që është tani. Edhe kur përjetuam kohët më të vështira nuk u dorëzuam, dhe tani ndodhemi këtu duke festuar përvjetorin tonë të 30-të. Ashtu si gocat e detit përdorin rërën irituese për të krijuar perlat e mrekullueshme, ne përdorim disfatat për t'u forcuar më shumë. Perla është një shembull i përsosur se si mund t'i mposhtim sfidat me të cilat përballohemi nga dita në ditë. Kur rruga fillon të ngrihet dorëzohemi, por në këtë rast s'kemi për ta ndjerë kurrë shijen e ëmbël të fitores në anën tjetër.


30 vjet kaluan shpejt, por duke patur parasysh kujtimet e vjetra që na sollën aq shumë humor dhe lumturi, më duket sikur kanë kaluar vetëm 30 ditë. Një nga gjërat më me vlerë në Forever jeni ju. E kam përmendur disaherë, dhe po e theksoj përsëri se ne jemi më të mëdhenjtë. Rrethohem nga më të mirët! I falenderoj të gjithë për punën e madhe vetësakrifikuese që e bëri Forever-in një perlë të mrekullueshme. Më pëlqejnë këtë vite, dhe sllogeni "30 Years of Forever, A Foundation of Excellence" është tepër i goditur, por unë mendoj se zhvillimin do ta shprehte edhe më mirë sllogeni "30 Years of Forever, It's a Good Start!"

Punojmë vazhdimisht në ide të reja që Forever-i të fluturoj mëtej edhe në 30 vitet e ardhshme dhe më pas. Jemi krenar për atë që kemi arritur deri tani, por duhet ta tregojmë veten edhe në të ardhmen dhe duhet të hapim fusha të reja për distributorët. Me kënaqësi të madhe njoftoj se filloi punën Forever You Tube Channel i cili mund të gjendet në internet: <http://www.Youtube.com/user/AloePod>. Forever s'ka qenë kurrë kaq i fortë sa në çerekun e parë të vitit 2008. Nëse kjo ngritje vazhdon me këtë ritëm, atëherë në vitet e adshme do e kalojmë qarkullimin prej 3 miliard dollarësh në vit. Pyetja e vetme është se sa do të jetë pjesa jote? Faleminderit që edhe ti je pjesë e familjes Forever.



KUALIFIKIMET E RALLY-T EUROPIAN

1 korrik – 31 tetor



Niveli 3

Plotësoni 80 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- Bileta hyrje në Rally* dhe dhuratat e nivelit 1
- 3 netë në hotel
- udhëtimi me avion



Niveli 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- Bileta hyrje në Rally* dhe dhuratat e nivelit 1
- 3 netë në hotel



Niveli 1

Plotësoni 25 CC (bashkë me pikët personale dhe distributori të vjetra) me skuadrën tuaj të re

- Bileta hyrje në Rally* dhe mbrëmjen festuese, veshje uniformë Rally dhe dhurata speciale Rally



Kushtet e reja të kualifikimit për në çdo nivel: Sponsorizoni të paktën tre distributor të drejtpërdrejtë (të gjeneratës së parë) të cilët arrijnë nivelin e Assistant Supervisorit. Të jeni "Aktiv" në çdo muaj të periudhës së kualifikimit. Periudha e kualifikimit zgjat katër muaj njëri pas tjetrit, gjatë të cilëve mund të arrihen tre nivele të ndryshme. Kushtet duhen plotësuar gjatë periudhës së kualifikimit. Të kualifikuarit duhet të jenë aktiv me 4 pikë personale në muajin e parë të plotë të periudhës së kualifikimit si dhe në muajt e tjerë të kësaj periudhe (përshembull: nëse një distributor hyn në mes të muajit në FLP, duhet të jetë aktiv vetëm në muajin e ardhshëm. Natyrisht edhe pikët e mbledhura në muajin e parë – jo të plotë – u shtohen pikëve të përgjithshme të kualifikimit). Përfundimisht nga rregulli përbën vetëm muaji i fundit. Distributori i ri i kualifikuar në nivelin 1, 2 apo 3, i cili hyn në FLP në muajin e fundit të periudhës së kualifikimit, duhet të jetë aktiv në këtë muaj. Data e hyrjes së distributorit është ajo e regjistrimit të të dhënave të Fletës së tij të regjistrimit në sistemin kompjuterik të kompanisë qëndrore. Shpërblimet nuk mund të shkëmbehen në para. Shpërblimet nuk mund t'u jepen të tjerëve. Kualifikimi u përket vetëm distributorëve europian. Është e rëndësishme që çdo anëtar skuadre i linjës së poshtme të regjistrohet në shtetin ku banon. Çdo distributor mban përgjegjësi për interpretimin e duhur të kushteve të mësipërme. Sekziston mundësia e trajtimit të veçantë. Për çdo pyetje që keni drejtohuni Drejtorit tuaj gjeneral.

World Rally, 2

Erdhi dita e madhe dhe u mblodhëm në aeroportin e Ferihegyi-t.

Miklos Berkics dhe Jozsef Szabo distributorët më të suksesshëm të Hungarisë, Veronika dhe Stevan Lomjanski distributorët më të suksesshëm të rajonit sllavo-jugor, Tomislav Brumec distributori më i suksesshëm i Sllovenisë, Peter Lenkey drejtori i tregëtisë europiane të FLP-s dhe bashkëshortja e tij Zsuzsi Lenkey. Familjen e tyre për shkak sëmundje e përfaqësova vetëm unë.

Në bazë të rezultatit të vitit 2007 u formua skuadra që përfaqësonte Hungarinë dhe rajonin tonë në World Rally-n e 2008-s në Tailand. Rezultatit, në bazë të të cilit arrita të marrë pjesë në këtë aktivitet, nuk e arrita vetëm por me skuadrën time. Dëshiroj të falenderoj skuadrën e non-managerëve për punën e cila solli këtë rezultat.

Të gjithë punuan në mënyrë të shkëlqyer, por theksohet puna e tre bashkëpunonjësve të mi të cilët tashmë janë manager, Erika Varga Csonkane, Tamas Sukaly dhe Monika Kalman. I falenderoj në mënyrë të veçantë për punën e tyre. Do të bëj gjithçka që energjinë që morra në këtë aktivitet ta shfrytëzoj dhe t'ia përcjell skuadrës sime dhe njerëzve.

Para se të niseshim Miki dhe Jozsi na thanë se ky aktivitet është ndryshe nga Super Rally. Ka më pak pjesëmarrës dhe më shumë kohë për njohjen e njëri-tjetrit dhe krijimin e marrdhenieve.

Miki tha se në aktivitet do të jenë afërsisht 200 vetë. Në Super



lu përshëndes të gjithëve. Jam Janos Tamas. Në fund të prillit pata mundësinë të marrë pjesë në aktivitetin më të madh me përmasa botërore të FLP-s, në World Rally. Për fat të keq morrëm pjesë pak vetë, prandaj mendova t'i bëj të njohur për të gjithë një pjesë të mbresave të mia të ilustruara me fotografi.

2008



vend në hotelin më elegant të Bangkokut me 15 milion banorë, në Dusit Thani Hotel. Të gjithë u pritën me kurorë lulesh. Pas arritjes në hotel skuadra hungreze me drejtimin e Jozsi Szabo-s u nis të shikonte qytetin dhe të bënte pazar. Ishte një eksperiencë e bukur të shikoje pazarin e njohur të Bangkok-ut të largët, të shikoje se si jetojnë këtu njerëzit tepër të dashur dhe gjithmonë të buzëqeshur. Dhe gjatë bërjes së pazarit u argëtuam shumë, falë Jozsi Szabo-s.

Dita e dytë ishte plot me program. Pas mëngjesit shkua me autobusa në tempullin më të njohur budist, Emereld Buda. Ndërtesa, shtylla të mrekullueshme të veshura me ar, vendi i banimit të mbretit, Buda prej ari. Hëngrëm drekë në një restorant lluksoz në anije në lumin e Bangkokut, Chao Phraya, pastaj me varka të gjata e

drejtuesit më të rëndësishëm të FLP-s në botë.

Të nesërmen paradite kishim program të lirë, të cilin e kalova bashkë me Miki Berkics-in, Jozsi Szabo-n dhe Peter Lenkey-n. Faleminderit që më pranuat dhe më dhuroat vëmendjen dhe miqësinë tuaj.

Në mbrëmje morrëm pjesë në aktivitetin e World Rally-t. Shfaqja e çdo shteti të pranishëm, zgjedhja e mbretëreshës së bukurisë Sonya tailandeze, vlerësimi i distributorëve vendas, program argëtues. Aktiviteti përfundoi në agim. Të nesërmen gjatë ditës program i lirë, në mbrëmje shëtitje me anije lluksoze të shoqëruar me darkë. Ishte e mrekullueshme të shikoje nga lumi dritat e mbrëmjes dhe ndërtesat e ndriçuara të Bangkokut.

Dita tjetër kaloi me ekskursion. Tempuj budist, qyteti Ayutthaya, hekurudha e vdekjes,

Jozsi Szabo-s. Vizitua kampin e njohur të elefantëve. Prezantim elefantësh, ngarje elefantësh me Miki Berkics-in, rafting në lumin e rrëmbyer me Jozsi Szabo-n dhe Miki Berkics-in. Ishte një mbresë e paharrueshme.

Ditën më pas shkua me avion në vendin e pushimit lluksoz të njohur, në ishullin Puket. Ishte i mrekullueshëm oqeani Indian, rëra e bardhë, hoteli lluksoz dhe bisedat e mbrëmjes.

Pastaj erdhi dita e kthimit. Drejt aeroportit, mëngjesi i fundit bashkë me të tjerët.

World Rally i 2008-s ishte një aktivitet fantastik. Në çdo moment m'u duk se për FLP-n, Rex Maughan-in, Gregg Maughan-in, drejtuesit e mi të lartë hungarez, Miki Berkics-in, Jozsi Szabo-n, drejtuesit e FLP Serbisë Veronika dhe Stevo Lomjanski-n, Peter dhe Zsuzsi Lenkey-n ishte e rëndësishme që ndodhesha aty dhe e ndjeja mirë veten.

Jam shumë i kënaqur që mund të ndodhesha aty dhe bashkë me të tjerët të përfaqësoja Hungarinë. Ky vend i vogël ka arritur një rezultat madhështor i cili vlerësohet kudo në botë.

Në World Rally të gjithë e dinin se ku ndodhet Hungaria. Ishte diçka fantastike të ndjeje dashamirësinë dhe respektin e të pranishmëve ndaj ne hungarezëve.

I uroj të gjithëve nga zemra që të marrin pjesë në ndonjë World Rally. I falenderoj bashkëudhëtarët e mi për miqësinë dhe mbresat e shumta, faleminderit FLP, faleminderit Rex Maughan.

Në 2009-ën World Rally do të jetë përsëri në një vend të mrekullueshëm. Në AFRIKËN E JUGUT!

U uroj të gjithëve suksese të shumta



Janos Tamas
Soaring manager



Rally kisha marrë pjesë 7 herë, por për në World Rally tani arrita të kualifikohem për herë të parë.

Skisha qenë ndonjëherë në Tailand, prandaj po i prisja me padurim këto 10 ditë.

Pas 11 orë fluturimi mbërritëm në Bangkok, në kryeqytetin e Tailandës me 55 milion banorë.

Bashkëpunonjësit tanë të FLP Tailandës na pritën që në aeroport. Na kishin prenotuar

të ngushta me motorr bëmë një udhëtim në kanalet e Bangkokut. Ishte tepër madhështore dhe mësimdhënëse.

Në mbrëmje, në darkën e hapjes drejtorët gjeneral e prezantuan secilin personalisht përpara Rex Maughan-it, Gregg Maughan-it dhe të pranishmëve të tjerë.

Ishte një mbrëmje e shkëlqyer ku u njoha personalisht me

ura e lumit Kway, darkë në lumin Kway. Ishte shumë nxehtë, por udhëtuam në një kupe me Rex Maughan-in dhe bashkëshorten e tij. Ditën më pas udhëtuam me avion në veri të Tailandës, në qytetin Chaing Mai. Këtu kaluam 2 ditë. Vizitua përgatitësit e njohur të çadrave. Piktoret pikturuan gjëra të bukura në këmbën e pantallonave të Veronika Lomjanski-t dhe bluzën e

Ka shumë gjëra për të cilat themi faleminderit. Një nga më rëndësishmet janë fëmijët tanë të mrekullueshëm, **Szonja** dhe **Benjamin**, të cilët erdhën me shëndet të plotë në këtë botë. Në lindjen e fëmijës sonë të parë luajtën rol edhe produktet Forever, pasi sponsori ynë **Rex Alex** na thirri vëmendjen për efektin ndihmues në rënien shtatzanë të berry nektar-it, dhe kështu hymë në kontakt me kompaninë. Kur na u bë e qartë mundësia e ofruar nga network marketing, duhet të vendosnim vetëm që cila është firma, sfondi, shkalla e produkteve, plani marketing dhe drejtimi i të cilës na jep në dorë zgjidhjen më të sigurt për të përmirësuar jetën tonë.

Nuk kemi qenë asnjëherë në periferi të shoqërisë. Unë kisha afërsisht dhjetë vjet që punoja si inxhinier elektrik me diplomë shkëlqyeshëm në një nga firmat multinacionale më të mëdha të botës në postin e drejtuesit të zyrës së zhvillimit, kurse bashkëshortja ime si ekonomiste zotëronte njëllë një karrierë të suksesshme në sketorin e shërbimit dhe turizmit. Edhe ne na mungonta ajo që u mungon të gjithë njerëzve të suksesshëm: koha e lirë. Pas librit të *Robert Kiyosaki-t: Plaku i Pasur* na ndryshoi pikëpamja rreth botës, u bëmë më të hapur dhe kërkonim mundësinë e nisjes së një biznesi privat pranë të cilit mund të kishim edhe kohë të lirë. Në këtë kohë u shfaq në jetën tonë plani i biznesit Forever.

Shumë njerëz kur u shfaqet në jetë, për shkak të thashethemeve të dëgjura më parë nga ata që e kishin provuar pa sukses dhe mungesa e të ardhurave fikse janë skeptik në lidhje me biznesin MLM. Ne, falë zotit, nuk i dëgjuam këto zëra të jashtëm, por që nga momenti i parë kërkuam njerëz, kasete, cd dhe libra të cilët nga ana profesionale përbëjnë garanci edhe për suksesin tonë.



MUNDËSIA më e madhe

Sipas një thënie, Ty, se si të bëhesh milioner, mund të të mësoj vetëm një milioner i cili është bërë i tillë me forcat e veta. Për fatin tonë në Forever ka shumë milioner të tillë dashamirës. Për ne u bë shpejt e qartë se ndërtimi i këtij rrjeti marketing bazohet në 2 rregulla të rëndësishme:

1. Në afat të gjatë dikush mund të bëhet i suksesshëm vetëm në rrugë të ndershme: gjënjeshtra, zmadhimi i gjërave, mungesa e karakterit dhe premtimet e papërgjegjshme e groposin suksesin e biznesit.

2. Në një rrjet të madh konsumatorësh shumë njerëz bëjnë gjëra të thjeshta për një kohë të gjatë. Ky është qëllimi përfundimtar.

Në thelb këto dy mendime bazë s'janë tjetër veçse motoja e kompanisë në 2 fjalë: Pastër dhe thjeshtë.

Në rastin e prezantimit të një firme gjithçka varet nga drejtimi i saj, siç u shpreh dikur John Maxwell. Përfaqësuesit shembullor të kësaj sot janë drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz**, pa mjeshttrinë dhe drejtimin special të punës të të cilit sot nuk do të ndodheshim në krye të botës, dhe rrjetndërtuesi më i suksesshëm i Europës **Miklos Berkics**, i cili punon me shumë modesti në fushën e MLM-s. Ata kontribuojnë edhe në nivelin ndërkombëtar që ndërtimi i rrjetit të hyj në opinion si një profesion elit.

E dinim që nga fillimi se nëse rruga drejt suksesit është e ngadaltë, nuk do të thotë se gabimi qëndron në sistem. Ndoshta duhet të forcojmë qëndrimin tonë ndaj sistemit. Kemi mësues të shkëlqyer të cilët na i mësuan në praktikë këto parime bazë njerëzore dhe biznesi, dhe i rrënjosën në mënyrë të përsosur mendimet e Brian Tracy-t në degën e biznesit të marketingut në rrjet. Falenderojmë linjën tonë të sipërme **Teca Herman**-in

e cila na kushtoi vëmendje menjëherë pasi hymë në biznes. Si "nipër të prindërve të ndarë" ne e treguam veten në biznes falë çiftit tepër të fortë **Tamas Biro** dhe **Dr. Adolf L. Kosa**, të cilët na krijuan një mjedis për përvetësimin e profesionit ku ishte kënaqësi të mësoje. Tamas edhe sot e kësaj dite është i pranishëm në biznesin tonë si mësues dhe mik.

Jo shumë kohë pas kualifikimit tonë si manager lindi managerja jonë e parë, **Krisztina Kiraly**, e cila tashmë është senior manager. Shembulli i saj e tregon në mënyrë të përsosur se si dikush në moshën 24 vjeçare, me diplomë të freskët, pa patentë, nga provinca, me një sfond material plot borxhe, vetëm me dëshirën për të mësuar, qëndrimin pozitiv dhe ndihmën e punës së përqendruar mund të ndryshojë plotësisht personalitetin dhe jetën e tij, të cilën që atëherë e kanë zili të gjithë.

Krisztina tërhoqi në biznes shumë talente si ylli i medias **Andrea Varga**, apo **Zoltan Toth**, me pseudonimin Sagi, i cili është kryetari i

shoqatës së këcimtarëve break hungarez dhe lëviz me shumë mbi kokë se sa në këmbë. Nga kjo skuadra jonë morri vrull më të madh dhe u bëmë shpejt të pavarur. Me ndihmën e linjave vëllazërore **Csilla Szekely** dhe **Peter Sandor**, sot edhe ne mund të punojmë në një mjedis ku sponsorizimi, prezantimet e hapura dhe bisedat miqësore zhvillohen pranë një kapuçino fantastike, çaj të shijshëm apo çokolllatë të nxehtë. Skuadra jonë jeton një jetë të shëndetshme dhe gjithmonë e më shumë njerëz e gjejnë vetveten si ndërtues biznesi. Managerët tanë të frontit të mëpasshëm, **Krisztina Gulyka Barsony** dhe **Balazs Barsony** u lidhën me ne si ekonomist të rinj të suksesshëm, Balazs punonte se drejtuesi i financës së një shoqërie aksionesh, kurse Krisztina si dora e djathtë e drejtuesit të një firme të shërbimit urban. Karriera e tyre edhe në Forever ishte e planifikuar pothuajse nga ora në orë, pasi edhe atyre u mungonte koha e lirë. Ata janë mjeshttrat e precizitetit, e ndërtuan biznesin e tyre

me gjakftohtësi, qetësi, pikësynime të qarta dhe gjithmonë të qeshur, duke mos lënë pas dore asnjë aktivitet. Nga dita në ditë skuadra e tyre është më e fortë dhe rrezaton inteligjencë dhe afirmim nga jeta.

Nga sfera e tregëtarit deri tek nëpunësi me rrogë të vogël, nga Ozdi në Szekesfehervar, dhe nga Italia në Estoni përhapet sot biznesi drejtuesit e të cilit jemi ne. Bashkëpunonjësit tanë nga provinca dhe jashtështetit i mbështesim nëpërmjet internetit, me ndihmën e të cilit mesazhin e Forever-it sot mund ta dërgojmë kudo.

Paga fikse u zëvendësua vazhdimisht nga të ardhurat gjithmonë e në rritje të tregëtarit, orën gjashtë me zile të mëngjesit e zëvendësoi puthja e fëmijëve tanë, të cilën e marrim kur ata ngrihen nga gjumi. Të tilla janë sot zgjimet tona. Në ditët tona tani kemi kohë për ekskursion, shëtitje të përbashkët, blerje, mësim patinazhi, skish, noti apo anglishteje fëmijëve tanë. Shëndeti ynë garantohet nga shkalla e produkteve të Forever-it, kurse stresi u ul nga fakti i sigurt i të ardhurave nga e drejta e autorit. **Cilësia e jetës sonë është shumëherë më e mirë se sa ishte para FLP-s.**

Përgjegjësia jonë e vetme është prezantimi cilësor i biznesit Forever dhe që edhe të tjerët të vendosin në bazë të informacioneve objektive rreth shëndetit të tyre dhe këtij biznesi. Forever është mundësia më e madhe në botë. Në treg s'është vërtetuar të ketë më të mirë. Iu urojmë edhe Juve ta shfrytëzoni sa më mirë këtë mundësi fantastike, dhe që nëpërmjet saj edhe Ju të jetoni një jetë të plotë!



Adam Nagy dhe Brigitta Belenyi
Senior manager

TRE HAPAT DR

U drejtohem punonjësve që kanë vendosur të mbajnë flamurin e shëndetit dhe suksesit sipas mentalitetit tonë të përbashkët në ndërtimin e rrjetit marketing, dhe përveç suksesit kanë përjashtuar çdo mundësi tjetër.

Suksesi nuk është një veprim i momentit, por rezultati i një procesi të vazhdueshëm të kryer në radhët tona. Bashkëpunonjësit tanë që u bënë të suksesshëm para 21 marsit i arritën pikësynimet e tyre, të tjerë priten nga sukseset në të ardhmen, kurse ata që nisen tani po shkelin rrugën drejt suksesit.

Angazhimi na siguron një frymëzim të pashtershëm në çdo hap në rrugën drejt suksesit, sepse jep kuptim dhe një pamje të qartë.

Ndoshta e keni dëgjuar përrallën rreth punëtorëve që punojnë në gurorë: grupi i parë e kreu punën duke djersitur gjak me shpresën e marrjes së shpërblimit ditë, kurse grupi tjetër kreu të njëjtën punë, por e dinte se nga gurët e nxjerrë ndërtohej një katedrale për gjeneratat e atëhershme dhe të ardhshme. Grupi i dytë punoi me më shumë rezultat se i pari, morrën shpërblim më të madh, dhe përveç kësaj ishin krenar për veprimtarinë e tyre, kurse fëmijët për prindërit e tyre.

Për suksesin duhet frymëzim, por nevojitet edhe puna, vendimet dhe rutina, e cila mund të përvetësohet me përsëritje dhe përsosmëri.

Në veprimtarinë tonë të kryer – në çdo muaj – në rrjet rutinë është e rëndësishme sidomos në tre fusha. Me këtë mund ta rrisim qarkullimin dhe rendimentin tonë edhe me 30 deri në 60%.

Fusha e parë është planifikimi, sepse pa një plan të përpunuar mund të realizohet vetëm parimi "gozhdë gjen edhe pula plakë": kjo pulë e pickon fortë në të gjitha drejtimit tokën rreth saj duke gjetur me këtë pak ushqim, por në fund të ditës është shumë e kënaqur sepse punoi shumë dhe me punë të ndershme i siguroi vetes një farë sasive ushqimi. Puna pa plan të përpunuar në rrjetin marketing sjell nga muaji në muaj sasi më të vogla pikësh shpërblimi.

Përgatitja e planit bëhet më mirë në fund të muajit, në mëngjes ose në mbrëmje. Kësaj pune të rëndësishme kushtojni një kohë të veçantë, kur vendimet e marra të jenë të fuqishme. Planifikimi për një kohë të gjatë s'është produktiv, sepse kalon në ëndërrim, humbet vullin dhe qëllimin, dhe me këtë kjo veprimtari ulet në nivelin e planifikimit alibi.

Në muajin e ardhshëm bëhet zakon përpunimi i planit mujor bashkë me gjithë

skadrën, sepse me të gjithçka ecën më shpejt e më mirë.

Shënoni vetëm punonjësit e linjës së parë dhe punonjësit e tyre, të cilët kanë ndërtuar një rrjet me thellësi të konsiderueshme. Flisni me ta rreth planit të tyre të muajit të ardhshëm dhe mbani shënim qarkullimin që prisni nga çdo bashkëpunonjës. Qëllimi juaj është që të përgatitni një plan real, prandaj duhet të shënoni qarkullimin real të pritur.


Lu vjen në ndihmë shfletimi i shënimeve të qarkullimit të muajve të kaluar, listës së emrave dhe bashkëpunonjësve, si dhe libri telefonik.

Nëse në fillim të muajit keni përgatitur radhën e emrave të cilët do të kenë nevojë për produktet dhe gjatë gjithë muajit çdo mëngjes apo mbrëmje e rishikoni planin, atëherë në atë muaj të gjithë kanë për t'i marrë produktet e pritura nga Ju, kurse qarkullimi juaj në këtë periudhë rritet me 10-20%. Pas çdo produkti të shitur qarkullimi juaj do të rritet me një ose dy produkte.

Hapi tjetër është sponsorizimi i konsumatorëve apo krijimi i bashkëpunonjësve nga konsumatorët, me të cilin mund të sigurohet një rritje tjetër qarkullimi prej 10-20%.

Me procesin e sponsorizimit të konsumatorëve kuptojmë konsiderimin që nga momenti i parë të konsumatorit dhe mjedisit të tij si bashkëpunonës, dhe jo si blerës apo të sëmurë.

Këtë e bëjmë për dy shkaqe: në radhë të parë, në momentin kur konsumatorët fillojnë të konsumojnë produktet e vërtetojnë vendimin e tyre përpara mjedisit rrethues dhe sillen si punonjës duke e prezantuar mirë FLP-n dhe produktet e saj.



REJT SUKSESIT

Në radhë të dytë është në interes të konsumatorit të bëhet punonjës, sepse kështu FLP-ja i ofron më shumë dhe ka përparësi në krahasim me konsumatorin. A kam të drejtë?

Kur konsumatorin e konsideroni si bashkëpunonjës, atëherë do të keni shkak të fortë që vetëm për një Lips të uleni në makinë dhe të shkoni në zonën fqinje, sepse kjo nuk është tregëti apo mjekim – me këtë Lips ju rrisni rrejtin marketing.

“Filialin” e parë të rrejtit të Veronika dhe Stevo Lomjanski-t – pikërisht falë një Lipsi – e bleu sponsori ynë i lartë, soaring manageri Adam Kibedi.

A ia vleu Veronika dhe Stevo Lomjanski-t të udhëtonin nga Novisadi i Vojvodinës deri në Szeged të Hungarisë për t’i shitur një Lips Adam Kibedi-t – dhe që atëherë sa para kanë bërë falë atij Lipsi? – këtë vlerësoheni vetë.

Miklos Berkics këtë proces e quan shndërrimi i konsumatorit

në punonjës me ndihmën e këshillave, rekomandimeve dhe informimeve.

Konsumatori na e bën të qartë që në blerjen e parë që ka besim tek ne, tek produktet dhe FLP-ja.

Në këtë takim të parë ju dhuron 15 minuta me vlerë të interesimit të tij. Është shumë e rëndësishme që në këtë kohë të mësoni sa më shumë rreth konsumatorit dhe mjedisit të tij, sepse kështu mund të përgatiteni për takimin e ardhshëm pas dy ditëve.

Takimi i parë – dhe të tjerët që vijnë më pas – në radhë të parë hedhin bazat e takimeve dhe marrdhënieve të mëpasshme, sepse me këtë hidhni një hap përpara tek konsumatori, bashkëpunonjësi dhe manageri i degës së ardhshme të rrejtit marketing.

Lini me të një kohë të përshtatshme kur pas një ose dy ditësh të paraqiteni në telefon. Nëse konsumatori tregon një interes të madh apo lufton me probleme serioze shëndetësore, atëherë telefonatën lijeni në ditën e nesërme.

Në kalendarin tuaj hapni një faqe të re për konsumatorin tuaj të ri dhe shënoni takimin, çfarë bleu, vërejtjet dhe pyetjet e tij, sepse me këtë do të jetë shumëherë më efektiv takimi i ardhshëm.

Bën përshtypje shumë të mirë nëse gjërat e rëndësishme i mbani shënim para konsumatorit, dhe njëkohësisht është e dobishme sepse kështu nuk i harroni ato. Gjithçka që bëni para konsumatorit është shembull, sepse u tregoni se si duhet kryer kjo punë. Merrni prapa atë që u tregoni. Silluni thjeshtë, me dashamirësi, me vëmendje dhe mirëkuptim, por me mjeshtri.

Pas kësaj takimi i ri të vijë pas një ose dy ditësh, dhe në kalendarin tuaj në faqen e tij fillon një kapitull i ri, ku shënoni se në ç’mënyrë i pranoni dhe i përdor produktet, pyetjet, përshtypjet dhe vërejtjet e tij të para, si dhe parapërgatitjet për takimin e ardhshëm.

Në takimin e tretë pas një ose dy ditësh interesoheni për problemet e tij – i shpjegoni



se si mund ta ndihmojnë produktet, e pyesni se si reagon mjedisi i tij, sepse kështu jeni gati për takimin e ardhshëm shumë të rëndësishëm.

Për herë të katërt takohuni personalisht pas 7-15 ditësh. Pas kaq kohe pritët përmirësim në gjëndjen shëndetësore dhe me këtë hapet mundësia që të ndihmojë edhe mjedisin e tij. Flisni me të rreth mundësisë që mund të ndihmojë edhe njerëzit që jetojnë në mjedisin e tij.

Pas kësaj vijjnë dy takime të tjera brenda disa ditësh kur bisedoni rreth konsumatorit dhe miqve të tij që presin ndihmë.

Kur konsumatori u ngacmon kureshtjen një ose më shumë personave rreth ndonjë produkti, atëherë pason takimi i përbashkët, apo prezantimi i produkteve, dhe me këtë lind një skuadër e re.

Sipas Miklos Berkics-it, fituesit të Profit Sharing European, detyra e skuadrës së re është realizimi i 2 pikëve në atë muaj, 7 në muajin e ardhshëm dhe 18 në të tretin, e cila sjell nivelin Supervisor.

Me sponsorizimin e vëmendshëm të konsumatorit dhe konsultimin e rregullt me sponsorin e parë aktiv mund të arrihet një rritje qarkullimi mujor prej 10-20%.

Me këtë mbërritëm në hapin e tretë tepër të rëndësishëm, në një temë shumë të ndjeshme, rreth të cilës flasim rrallë.

Bëhet fjalë rreth trajtimit të kompletit të produkteve. FLP-ja nuk lejon blerjen e produkteve për qëllim përparimi, realizimi të Programeve Motivues apo përfitimi të një produkti

të ri deri në përdorimin e ¾ kompletit ekzistues.

Programe të tjera MLM bëjnë pikërisht të kundërtën – stimulojnë blerjen sa më të madhe me ulje dhe dhurata me vlerë.

Si mendoni, përse e bëjnë këtë? A nuk është interesi i firmës të shesë sa më shumë produkte? Në të vërtetë ky është qëllimi, por s'ka për interes që të krijohen grumbuj të mëdhenj produktesh mes prodhuesit dhe konsumatorit.

Grumbullimi i madh i produkteve mund ta mbys tregëtinë dhe këtë e dinë të gjithë ata që merren me këtë.

FLP pikërisht me këtë mbron punën tonë dhe të vet – sepse kështu mund të funksionoj për një kohë të gjatë. Shumë sisteme MLM janë shkatërruar nga grumbullimi i produkteve, ku fillimisht falimentuan distributorët pastaj edhe firmat e tyre.

Çdo përjashtim përforcon rregullin, kështu që edhe këtu ka përjashtime. Në kompaninë FLP asgjë nuk ndodh rastësisht, prandaj ky përjashtim është i shpjegueshëm.

Përse nevojitet paketa e produkteve Touch of Forever?

Në radhë të parë nuk mund të ndihmojmë të tjerët nëse nuk i njohim vetë produktet.

Kur i bëjmë të njohur mjedisit tonë se ne predikojmë mentalitetin e shëndetit dhe suksesit, njerëzit presin nga ne që t'i ndihmojmë ata kur kanë më shumë nevojë dhe që kjo të ndodhë sa më shpejt e sa më mirë. Nëse nuk u ofroni ndihmë të shpejtë, u drejtohen të tjerëve.

Edhe nëse konsumatorët duhet të presin disa ditë për

produktet, kjo merr aq ditë sa i nevojiten konsumatorit që të paguaj produktet, që të mbledh shumën e nevojshme për porosinë minimale, që ju të shkoni për produktet dhe t'ua dorëzoni konsumatorit.

Mund të punoni edhe në këtë mënyrë, por nëse i keni gjithmonë në dorë produktet e rëndësishme si p.sh. Xhel, First, krem të kuq, Lips dhe disa produkte të tjera të kërkuara më shpesh, atëherë qarkullimi juaj në atë muaj mund të rritet me 10-20%.

Shtrohet pyetja: Çfarë sasive produktesh nevojitet për të përshpejtuar punën dhe me këtë të rrisni qarkullimin?

Pak produkte mënjane nuk e përshpejtojnë qarkullimin, e mbysin mundësinë e punës dhe mund të humbas edhe besimi në FLP.

Me blerjen e paketës së produkteve Touch of Forever përveç 2,7 pikëve që vlen, marrim falas produkte me vlerë 130 euro, ndërkohë që ne paguajmë 2 pikë dhe marrim po 2 pikë në llogarinë mujore.

Kur i blini, i konsumoni apo i shisni produktet që gjenden në Touch of Forever, atëherë ajo u ofron një ndihmë të vetme, por nëse e plotësoni vazhdimisht përmbajtjen e saj e përshpejtoni shumë qarkullimin dhe mund ta rrisni rendimentin mujor me 10-20%.

...sepse Touch of Forever pa produkte nuk është më Touch, por vetëm një kuti...

Nuk njoh asnjëri në këtë biznes të ketë arritur nivelin e managerit pa zotëruar kuti produktesh Touch of Forever apo sasinë e produkteve që ndodhen në të. Nuk njoh as ndonjë manager i cili pas arrijtes së nivelit të managerit

mbeti aktiv dhe e përdori apo e shiti kutinë Touch of Forever dhe mbeti pa produkte.

Pa tre hapat e sipër-përmendura nuk mund të arrihet sukses në ndërtimin e rrjetit marketing.

Nëse e arrini nivelin e managerit pa planifikim, sponsorizim dhe trajtim me mend të produkteve, kjo do të thotë se ka punuar dikush tjetër në vendin tuaj: bashkëshorti ose sponsori juaj. Në këtë rast ky nivel nuk është suksesi juaj dhe nuk do të keni shumë përfitime nga ai – me përjashtim nëse ndërkohë mësoni se si duhet punuar dhe e përdorni këtë dituri në të ardhmen.

Në arritjen e suksesit është shumë i rëndësishëm qëndrimi dhe frymëzimi. Këtë mund ta bëni si punëtorët e përmendur të gorores, të cilët i nxirrin me përpjekje e vuajtje të mëdha gurët me shpresën e shpërblimit ditor, ose si grupi tjetër të cilëve u pëlqente puna, sepse me të kontribuan në ndërtimin e katedrales madhështore.

Pikësnyimet tona mund t'i realizojmë vetëm nëse ecim përpara me frymëzim dhe dashuri në rrugën e ndërthurur me mentalitetin e shëndetit dhe suksesit.

Mos harroni asnjëherë se keni mësuës falas – sponsorët, të cilët i realizojnë me kënaqësi së bashku me Ju vendimet tuaja.



Miodrag Ugrenović
Senior manager

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari. • **Redaktori:** FLP Magyarországi Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455 • **Redaktori kryesor:** Dr. Milesz Sándor • **Redaktor:** Kismárton Valéria, Petrőczy Zsuzsanna, Milesz Eszter Sára, Pósa Judit, Pósa Kálmán, Rókás Sándor • **Përgatitja për shtypje:** Tipofill 2002 kft. • **Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor, • **Fotograf:** BélaKanyó • **Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 koje • **Përthyes, redatues:** shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko – serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana
Për përmbajtjen e artikujve shkruesit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!



FOREVER RESORTS



1183 Budapest, rruga Fonal (pas depos së rrugës Nefejejs) Tel: +36-1-291-5474 • Mail: sasfeszek@foreverliving.t-online.hu
Orari i hapjes: çdo ditë 10.00 – 21.00

Sonya[®]
Color Collection

